



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë .10.2025

“PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË LEDWALL NË HYRJE TË QYTETIT.”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 15, pika 1, gërma b.), Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 3 pika 8, neni 41 dhe vendim "Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike" nr.1096 dt.28.12.2025, neni 3. ", bazuar në kërkesën e disa prej bizneseve që operojnë në territorin e Bashkisë Kolonjë dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës, 06.10.2025,

PROPOZOI:

1. Miratimin e vendit për vendosjes e Ledwall-it në hyrje të qytetit Ersekë, sipas planvendosjes bashkëlidhur. Qëllimi I vendosjes të ledwall është krijimi I një hapësire dixhitale, informuese dhe promovuese për komunitetin dhe bizneset.
2. Për zbatimin e këtij projekt- vendimi ngarkohen administrata e Bashkisë Kolonjë dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky projekt- vendim hyn në fuqi ne mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Kryetari
Erion ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. ____ prot

Datë __.10.2025

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë . .2025

“PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË LEDWALL NË HYRJE TË QYTETIT.”

Të nderuar!

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 **“Për Vetëqeverisjen Vendore”**, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 15, pika 1, gërma b.), Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 3 pika 8, neni 41 dhe vendim “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” nr.1096 dt.28.12.2025, neni 3. ”, dhe bazuar në kërkesën e disa prej bizneseve që operojnë në territorin e Bashkisë Kolonjë kërkojmë miratimin e vendit për vendosjes e Ledwall-it në hyrje të qytetit Ersekë.

Në Bashkinë Kolonjë është paraqitur një kërkesë nga disa biznese të zonës për vendosjen e një LedWall-i në hyrje të qytetit të Ersekës. Kjo nismë ka ardhur si rezultat i interesit të vazhdueshëm të sipërmartjes lokale për të pasur një hapësirë moderne promovimi dhe komunikimi, e cila njëkohësisht do t’i shërbejë edhe komunitetit në tërësi.

LedWall-i i planifikuar do të ketë një funksion të dyfishtë. Nga njëra anë, ai do të shërbejë si mjet informimi për qytetarët dhe vizitorët, duke shfaqur njoftime dhe mesazhe publike, aktivitete kulturore, sportive apo sociale me rëndësi për jetën e qytetit. Nga ana tjetër, do të shërbejë si platformë promocionale për bizneset, duke u ofruar atyre një dukshmëri të lartë në një pikë hyrëse dhe shumë të frekuentuar të qytetit. Ky kombinim e kthen projektin në një mjet të rëndësishëm për komunikim publik dhe për gjallërimin e jetës ekonomike.

Një element thelbësor i kësaj nisme është fakti se vendosja e LedWall-it nuk do të mbulohet financiarisht nga Bashkia, por nga vetë bizneset që kanë shprehur interes. Ky mekanizëm bashkëpunimi i jep projektit një karakter të qëndrueshëm dhe e shndërron atë në një model të partneritetit publik–privat. Në këmbim të financimit, bizneset përfitojnë hapësira reklamuese falas për një periudhë të përcaktuar, e cila do të formalizohet përmes marrëveshjeve të posaçme midis Bashkisë dhe secilit biznes.


Vendosja e LedWall-it në hyrje të qytetit të Ersekës përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të komunikimit publik, promovimit të kulturës dhe ekonomisë lokale, si dhe forcimit të bashkëpunimit midis Bashkisë dhe biznesit. Kjo nismë është shembull i qartë i mënyrës sesi përmes partneritetit dhe vizionit të përbashkët mund të krijohen projekte me ndikim pozitiv për komunitetin.

JU FALEMINDERIT!

KONCEPTOI: Specialist K.Saliko

KONTROLLOI: Drejtor I D.A.K.S. Eni Duro

KONFIRMOI: Drejtori D.Ç.J.P. Q. RIFO



Kryetari
Erion ISAI

Në mungesë dhe me urdhër

Nënkryetar
Petro Risto



Vendi ku do të vendoset SCREEN LED WALL



Zemëmapia	
Mer koordinatat	
GJES 80	
LA	20° 41' 01.1804"
LO	40° 20' 28.0237"
UTM Zone 36N	
E	473132.34
N	446004.01
Albanian TSC / Gauss-Kruger Zone 4	
E	447329.83
N	446012.10
KRSJSH	
E	559088.04
N	446056.12
NDMME	
Mënyrë e ndërtimit të rrjetit të koordinatave	